



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Gjilan shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë Ligjor
Institucioni	Komuna Gjilan
Nr. i Referencës	RN00011143
Kodi	RPC0004789
Data e njoftimit	15.03.2023
Afati për aplikim	05.04.2023 - 19.04.2023



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

1. Zhvillimi i procedurave administrative për verifikimin e uzurpimeve të pronave komunale;
2. Dalja në vendin e ngjarjes - terren me ekipin e gjeodetëve për verifikimin e rasteve të uzurpimit të pronave komunale,
3. Hartimi i procesverbalit në vendin e ngjarjes,
4. Zhvillimi i seancave dëgjimore me palët në procedurën e uzurpimit të supozuar;
5. Nxjerrja e Aktvendimeve lidhur me verifikimin e uzurpimit të pronave komunale,
6. Regjistrimi i të drejtave pronesore në RDPP të rasteve të cilat nderlidhen me trojet në lagjen Dardania dhe pjeset tjera të qytetit të cilat kanë të bëjnë me prona komunale;
7. Zhvillimi i procedurave administrative të shpronësimit të pronave private për nevojë të interesit publik;
8. Bartja - regjistrimi i të drejtave pronesore në RDPP në emër të Komunes për kompensimit të pronave private të shpronësuara;
9. Hartimi i historiateve sipas kërkesave të paleve;
10. Regjistrimi i pronave në SIKTK;
11. Hartimi i raporteve të punës periodike dhe pefundimtare
12. Kryerja e punëve tjera sipas nevojës dhe kërkesës së menaxhmentit për çështjet pronësore - juridike.

2. Kërkesat e përgjithshme për praninë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK);

Kualifikime të posaçme formale: Fakulteti juridik

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1(një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internetit);

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës	Nr. i kërkuar
RPC0004371	RN00010702	Zyrtar Ligjor 2	Profesional 2	7	Komuna Gjilan	Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë / Sektori i pronës	1

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

Njohuri konform pozitës punuese

10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.



Të dhëna shtesë:

//

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

